



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 424

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

HEQJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE QË NUK PËRMBAJNË SHËNIMIN “PRODHUAR NËN PËRGJEGJËSINË LIGJORE TË ...” (VIJON EMRI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR)

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, dhe 2, nenit 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, si dhe vendimit nr. 414, datë 25.4.2023, “Për vendosjen nga subjektet zgjedhore të shënimit përkatës identifikues të materialeve propagandistike”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Organizata “Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)”, ka paraqitur në Komisionin Qendror i Zgjedhjeve, në datën 18.4.2023, sinjalizim mbi afishimin publik të materialeve propagandistike zgjedhore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, i cili është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Nga verifikimet e monitoruesve asnjë prej posterave të publikuar nga subjektet zgjedhore nuk respektonin parashikimin e pikës 3, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se “*Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)*”.

Për këtë arsye Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 414, datë 25.4.2023, “Për vendosjen nga subjektet zgjedhore të shënimit përkatës identifikues të materialeve propagandistike”, ju la afat të gjitha subjekteve zgjedhore që brenda datës 28 prill 2023 të vendosnin në materialet propagandistike të afishuara prej tyre, shënimin “*Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)*”.

Nga verifikimi dhe në vlerësim të dokumentacionit të administruar prej monitoruesve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rezulton se jo të gjitha materialet propagandistike të afishuara e përmbajnë këtë shënim.

Data: 3.5.2023 Nr: 424
Ora:12:00



“Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, dhe 2, nenin 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 21.03.2021, si dhe vendimit nr. 414, datë 25.4.2023, “Për vendosjen nga subjektet zgjedhore të shënimit përkatës identifikues të materialeve propagandistike”,

V E N D O S:

1. Heqjen e të gjitha materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).
2. Ky vendim do ju njoftohet subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake nëpërmjet postës elektronike.
3. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake.
4. Drejtuesit e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e këtij vendimi, brenda datës 5.5.2023, deri në orën 24:00.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI